Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, në kuadër të materialit që po përgatisni, Bashkia Sarandë, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", bën me dije sa vijon:

1. Buxheti vjetor dhe fondi për kulturën (5 vitet e fundit).

Viti	[redacted]
Buxheti vjetor	
Fondi	

2. Eventet kulturore dhe artistike të mbështetura nga Bashkia Sarandë

   Bashkia Sarandë mbështet dhe inicion aktivitetet kulturore dhe artistike me qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit lokal. Përgjatë sezonit turistik por edhe përgjatë vitit, aktivitete të organizuara janë:

   - "Vala Fest", një festival veror me karakter muzikor dhe artizanal;
   - Hapja e sezonit turistik - "Fish Festival";
   - "Portokalli", event humoristik që zhvillohet çdo verë;
   - "Solar fest", festival mzikor me artist të huaj dhe shqiptar;
   - "Saranda Christmas Market", event festiv që zhvillohet çdo fundvit;
   - Aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me tematika të ndryshme, në bashkëpunim me aktorë lokal (institucione dhe organizata të ndryshme), përgjatë gjithë vitit.

   Kostot përkatëse janë pjesë e buxhetit vjetor të sektorit të kulturës.

3. Eventet aktuale kulturore në qytet

   Bashkia ofron një kalendar të pasur eventesh gjatë gjithë vitit, me fokus në periudhën turistike qershor–shtator, që përfshin ekspozita arti, koncerte, performanca tradicionale dhe aktivitete promovuese të zonave historike e kulturore. Të gjitha eventet publikon te aplikacioni i turizmit TEA.

4. Në Bashkinë Sarandë funksionojnë institucione arti si:

   - Qendra Kulturore "Hasan Tahsini";
   - Galeria e Artit Bashkiak;
   - Ansambleja folklorike lokale;
   - Qendra Kulturore e Rinisë
   - Muzeu i Traditës.

   Këto institucione ofrojnë dhe zhvillojnë aktivitete e programe të ndryshme gjatë gjithë vitit dhe ndjekin një kalendar të miratuar nga Drejtoria e Kulturës ku përfshihen tematika të ndryshme.

5. Rikonstruksioni i Teatrit të Sarandës

   Bashkia Sarandë ka hartuar një projekt për rikonstruksionin e plotë të godinës së Teatrit të qytetit, me qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe rikthimin e funksionalitetit të këtij institucioni të rëndësishëm kulturor. Duke qenë se projekti kërkon një buxhet të konsiderueshëm për realizim, aktualisht jemi në fazë negociatash dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës për sigurimin e fondeve të nevojshme dhe përcaktimin e etapave të zbatimit.

   Aktualisht institucioni nuk është ne funksion, por Bashkia mbetet e angazhuar që të sigurojë mbështetjen e duhur për këtë investim me rëndësi të veçantë për jetën kulturore të qytetit.

6. Strategjia për mbështetjen e eventeve kulturore

   Në kuadër të zhvillimit të turizmit kulturor, Bashkia Sarandë ka si prioritet hartimin e një strategjie për promovimin e aktiviteteve artistike dhe përfshirjen e sektorit privat në nisma kulturore, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe partnerë ndërkombëtarë.

Ju falënderojmë për interesimin dhe bashkëpunimin!